



## KOMUNIKATË PËR PUBLIKUN

7 prill 2021

Youth Initiative for Human Rights - Kosovë, pas më shumë se një viti prej inicimit të rastit kundër avokatit Tomë Gashi për shkelje etike, sot ka dërguar kërkesën për trajtim me urgjencë të rastit në fjalë, pranë Zyrës së Prokurorit Diciplinor tek Oda e Avokatëve të Kosovës.

Në shkurt të vitit 2020, avokati Tomë Gashi kishte shkëlmuar gjësendet e një personi që kërkonte lëmshë në sheshin Nënë Tereza, i cili i takon njërit nga komuniteteve joshumicë. Rasti ishte mbuluar nga kamerat e vendosura në sheshet Zahir Pajaziti, Nënë Tereza e Ibrahim Rugova e poashtu edhe nga kalimtarë rasti. Policia pas marrjes së informatës menjëherë kishte inicuar rastin tek prokurori kompetent në kuadër të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, mirëpo fatkeqësisht kallzimi penal ishte hedhur poshtë me arsyetimin se veprimi i tillë nuk kishte përmbushur elementet e vepres penale të kanosjes sipas nenit 181 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Pas këtyre veprimeve shumë figura publike, politikanë dhe organizata të shoqërisë civile në Kosovë kishin reaguar në forma të ndryshme: reagime të shkruara, aksione rrugore etj.

Më 3 mars 2020, YIHR KS kishte paraqitur parashkresë për hapjen e procedurës disiplinore pranë Odës së Avokatëve të Kosovës për avokatin Tomë Gashi dhe kishte kërkuar nga Zyra e Prokurorit Diciplinor nisjen e procedurës së pavarur, profesionale hetimore kundrejt avokatit Tomë Gashi, cilësimin e veprimit të avokatit si shkelje e rëndë disiplinore dhe shqiptimin e masës “humbje e të drejtës së ushtrimit të profesionit të avokatisë për 4 vite”.

YIHR KS që nga inicimi i rastit tek Oda e Avokatëve të Kosovës në mars 2020 e deri më 7 prill 2021, është munduar që në vazhdimësi ta përcjellë rrjedhën e rastit në fjalë. Gjatë kësaj periudhe ka kontaktuar Odën e Avokatëve të Kosovës për 5 herë me radhë. Në disa prej kontaktimeve nuk kemi marrë fare përgjigje nga institucioni i Odës së Avokatëve, ndërsa në herat kur janë përgjigjur, na është thënë që lënda është në hetim dhe duke u proceduar.

Ne e konsiderojmë trajtimin e duhur të këtij rasti me rëndësi strategjike për shoqërinë tonë dhe minoritetet në përgjithësi. Kështuqë, marrja e licencës apo cilido dënim i shqiptuar ndaj avokatit në fjalë do të kontribuonte në mospërsërsëritjen e sjelljeve të tilla joetike të avokatëve dhe personave të tjerë publik.

Andaj, duke parë rrezikun që lënda të parashkruhet, ne së fundmi e dërguam kërkesën për urgjencë, në mënyrë që rasti të shqyrtohet sa më parë që është e mundur brenda afateve ligjore.